48. Parimi i sundimit të ligjit nuk imponon zgjedhje midis monizmit dhe dualizmit, por *pacta sunt servanda* zbatohet pavarësisht qasjes kombëtare ndaj marrëdhënieve ndërmjet së drejtës ndërkombëtare dhe asaj vendore. Sidoqoftë, zbatimi i plotë i brendshëm i së drejtës ndërkombëtare është thelbësor. Kur e drejta ndërkombëtare është pjesë e së drejtës vendore, ajo bëhet ligj i detyrueshëm në kuptim të paragrafit paraprak lidhur me epërsinë e ligjit (II.A.2). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ajo duhet të ketë gjithmonë epërsi ndaj Kushtetutës apo legjislacionit të zakonshëm.

4. Kompetencat ligjbërëse të ekzekutivit

A sigurohet epërsia e legjislativit?

- i. A përfshihen rregulla të përgjithshme dhe abstrakte në një akt parlamenti ose rregullore të bazuar në atë ligj, përveç përjashtimeve të kufizuara të parapara në Kushtetutë?
- ii. Cilat janë ato përjashtime? A janë të kufizuara në kohë? A kontrollohen nga Parlamenti dhe gjyqësori? A ka mjet efektiv kundër abuzimit?
- iii. Kur pushteti legjislativ i delegohet ekzekutivit nga Parlamenti, a janë të përcaktuara qartë me akt legjislativ objektivat, përmbytja dhe fushëveprimi i delegimit të pushtetit?²⁸

49. Kompetencat e pakufizuara të ekzekutivit janë, *de jure* ose *de facto*, tipar qendror i sistemeve absolutiste dhe diktatoriale. Konstitucionalizmi modern është ndërtuar kundër sistemeve të tilla dhe për këtë arsye siguron epërsinë e legjislativit.²⁹

27. Neni 27 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve; shih gjithashtu nenin 46 (Dispozitat e së drejtës vendore në lidhje me kompetencën për të lidhur traktate).

28. Shih nenin 80 të Kushtetutës gjermane; Neni 76 i Kushtetutës italiane; Neni 92 i Kushtetutës së Polonisë; Neni 290.1 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, i cili thotë se "elementet thelbësore të një fushe do të rezervohen për aktin legjislativ dhe nuk do të jenë objekt i delegimit të pushtetit".

29. GJEDNJ Sunday Times, shënimin sipër 25.

5. Procedurat e ligjbërjes

A është procesi i miratimit të ligjeve transparent, llogaridhënës, gjithëpërfshirës dhe demokratik?

- i. A ka rregulla të qarta kushtetuese për procedurën legjislativë?³⁰
- ii. A është Parlamenti organ suprem në vendosjen për përmbajtjen e ligjit?
- iii. A debatohet publikisht legjislacioni i propozuar nga parlamenti dhe a arsyetohet në mënyrë adekuate (*p.sh* me raporte shpjeguese)?³¹
- iv. A ka publikuar qasje në projektligje, të paktën kur të procedohen në Parlament? A ka publiku mundësi domethënëse për të parashtruar komente?³²
- v. Sipas nevojës, a realizohen vlerësime të ndikimit përpara miratimit të legjislacionit (*p.sh* mbi të drejtat e njeriut dhe ndikimin buxhetor të ligjeve)?³³
- vi. A merr pjesë Parlamenti në procesin e hartimit, miratimit, inkuorporimit dhe zbatimit të traktateve ndërkombëtare?

30. Për procedurat legjislativë që duhet të sqarohen dhe të integrohen, shih *p.sh* CDL-AD(2012)026, §79; *kf.* CDL-AD(2002)012, Opinion mbi draftin e rishikimit të Kushtetutës Rumune, § 38ff.
31. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rishikimi i përpiktë dhe përkatës i (projekt)legjislationit, jo vetëm a posteriori nga gjyqësori, por edhe a priori nga ligjvënësi, i bën më lehtë të justifikueshme kufizimet ndaj të drejtave themelore të garantuara nga Konventa: GJEDNJ Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar, 48876/08, 22 prill 2013, §106ff.
32. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Koment i Përgjithshëm nr. 25 (1996), Neni 25 (Pjesëmarrja në çështjet publike dhe e drejta e votës) - E drejta për të marrë pjesë në çështjet publike, të drejtat e votimit dhe e drejta për qasje të barabartë në shërbimin publik – parashikon se “[q]ytetarët gjithashtu marrin pjesë në drejtimin e çështjeve publike duke ushtruar ndikim nëpërmjet debatit publik” (§ 8). Në dispozicion në <http://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain?page=search&docid=453883fc22&skip=0&query=gjeneriteti> komenti 25. Dokumenti i KSBE-së i Kopenhagës parashikon se legjislacioni “miratohet në fund të një procedure publike” dhe Dokumenti i Moskës i vitit 1991 (<http://www.osce.org/odihr/elections/14310>) thekson se “[L]egjislacioni formulohet dhe miratohet si rezultat i një procesi të hapur” (§ 18.1).
33. GJEDNJ Hatton kundër Mbretërisë së Bashkuar, 36022/97, 8 korrik 2003, §128: “Procesi i vendimmarrjes qeveritare në lidhje me çështje komplekse të politikës mjedisore dhe ekonomike siç është rasti në fjalë, duhet të përfshijë medoemos hetime dhe studime të përshtatshme për t’i lejuar ato të arrijnë një bilanc të drejtë midis konflikteve të ndryshme të interesave”. Shiko gjithashtu Evans kundër Mbretërisë së Bashkuar, 6339/05, 10 prill 2007, § 64. Për mungesën e debatit të vërtetë parlamentar që nga miratimi i statutit, i cili u zhvillua më 1870, shih Hirst (nr. 2) kundër Mbretërisë së Bashkuar, 74025/01, 6 tetor 2005, § 79. Në Finlandë, udhëzimet për hartimin e ligjit përfshijnë një kërkesë të tillë.

50. Siç u shpjegua në pjesën hyrëse, sundimi i ligjit është i lidhur me demokracinë sepse e promovon llogaridhënien dhe qasjen në të drejtat që kufizojnë kompetencat e shumicës.

6. Përjashtimet në situata emergjente

A parashihen me ligj përjashtime në situata emergjente?

- i. A ka dispozita të posaçme kombëtare që zbatohen për situata emergjente (luftë apo emergjenca të tjera publike që rrezikojnë jetën e popullit)? A janë të mundshme shmangiet nga të drejtat e njeriut në situata të tilla sipas së drejtës vendore? Cilat janë rrethanat dhe kriteret e nevojshme për të shkaktuar një shmangie?
- ii. A e ndalon ligji kombëtar shmangien nga disa të drejta edhe në situata emergjente? A janë shmangiet proporcionale, gjegjësisht të kufizuara në mënyrë strikte në kohëzgjatje, rrethana dhe fushëveprim në masën e kërkuar nga urgjenca e situatave?³⁴
- iii. A janë mundësitë që ekzekutivi të shmangë ndarjen normale të pushteteve në rrethana emergjente gjithashtu të kufizuara në kohëzgjatje, rrethana dhe fushëveprim?
- iv. Cila është procedura për përcaktimin e një situate emergjente? A ka kontroll parlamentar dhe rishikim gjyqësor të ekzistencës dhe kohëzgjatjes së një situate emergjente, dhe fushëveprimin e ndonjë shmangie sipas saj?

51. Siguria e shtetit dhe e institucioneve të tij demokratike, si dhe siguria e zyrtarëve dhe popullatës së tij, janë interesa jetike publike dhe private që meritojnë mbrojtje dhe mund të çojnë në shmangie të përkohshme nga disa të drejta të njeriut dhe në ndarje të jashtëzakonshme të pushteteve. Megjithatë, kompetencat e veçanta në raste emergjente janë keqpërdorur nga qeveritë autoritare për të qëndruar në pushtet, për t'i mbyllur gojën opozitës dhe për t'i kufizuar të drejtat e njeriut në përgjithësi. Prandaj, është thelbësore që të ketë kufizime të rrepta në kohëzgjatje, rrethana dhe fushëveprim të këtyre kompetencave. Siguria shtetërore dhe rendi publik mund të sigurohen efektivisht vetëm në një demokraci që respekton plotësisht

34. Cf. Neni 15 KEDNJ ("shmangia në kohë emergjente"); Neni 4I KDGP; Neni 27 KEDNJ. Për zbatim individual të nenit 15 të KEDNJ, shih GJEDNJ A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, 3455/05, 19 shkurt 2009, § 178, 182: shmangia e nenit 5 § 1 të KEDNJ u konsiderua si joproporcional. Për pushtetet emergjente, shih gjithashtu CDL-STD(1995)012, Emergency Powers; CDL-AD(2006)015, Opinion mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Situata Emergjente.

sundimin e ligjit.³⁵ Për këtë nevojitet kontroll parlamentar dhe shqyrtim gjyqësor i ekzistencës dhe kohëzgjatjes së një situate të shpallur emergjente në mënyrë që të shmanget abuzimi.

52. Dispozitat përkatëse të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut janë të ngjashme.³⁶ Ato parashohin mundësinë e shmangieve (që dallojnë nga kufizimet e thjeshta të të drejtave të garantuara) vetëm në rrethana tejet të jashtëzakonshme. Shmangiet nga “të ashtuquajturat të drejta absolute: e drejta për jetën, ndalimi i torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues, dhe i skllavërisë, dhe parimi *nullum crimen, nulla poena*” ndër të tjera nuk janë të mundshme.³⁷ Pika II.A.6.i përmbledh kërkesat e këtyre traktateve.

7. Detyrimi për zbatim të ligjit

Çfarë masash janë marrë për të siguruar që autoritetet publike zbatojnë në mënyrë efektive ligjin?

- i. A janë analizuar pengesat për zbatimin e ligjit para dhe pas miratimit të tij?
- ii. A ka mjete efektive kundër moszbatimit të legjislacionit?
- iii. A parasheh ligji sanksione të qarta dhe specifike për mosrespektim të ligjit?³⁸
- iv. A ka sistem solid dhe koherent të zbatimit të ligjit nga autoritetet publike për t’i zbatuar këto sanksione?
- v. A zbatohen sanksionet në mënyrë konsistente?

53. Megjithëse zbatimi i plotë i ligjit është rrallëherë i mundur, një kriter themelor i sundimit të ligjit është që ligji duhet të respektohet. Konkretisht, kjo do të thotë që organet shtetërore duhet t’i zbatojnë ligjet në mënyrë efektive. Vetë thelbi i sundimit të ligjit do të vihej në pikëpyetje nëse ligji do të figuronte vetëm në letër, por nuk do të zbatohet siç duhet.³⁹ Detyrimi për

35. CDL-AD(2006)015, § 33.

36. Neni 15 ECHR: Neni 4 KNDKP; Neni 27 KEDNJ.

37. CDL-AD(2006)015, § 9. Për shmangiet sipas nenit 15 të KEDNJ-së, shih në përgjithësi CDL-AD(2006)015, § 9ff, dhe jurisprudencën e cituar.

38. Për nevojën për sanksione efektive dhe bindëse, shih p.sh CDL-AD(2014)019, § 89; CDL-AD(2013)021, § 70.

39. Nevoja për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit nënvizohet shpesh nga Komisioni i Venedikut: shih p.sh CDL-AD(2014)003, § 11: “Sfida kryesore për zhvillimin e zgjedhjeve të vërteta demokratike mbetet ushtrimi i vullnetit politik nga të gjitha palët e interesuara, për të mbështetur gërmën dhe frymën e ligjit dhe për ta zbatuar atë plotësisht dhe me efektivitet”; CDL-AD(2014)001, § 85.

të zbatuar ligjin është i trefishtë, meqë përfshin bindjen e individëve ndaj ligjit, detyrimin e shtetit për ta zbatuar ligjin në mënyrë të arsyeshme dhe detyrimin e zyrtarëve publikë për të vepruar brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

54. Pengesat ndaj zbatimit efektiv të ligjit mund të paraqiten jo vetëm si rezultat i veprimit të kundërligjshëm ose të pakujdesshëm të autoriteteve, por edhe për shkak se cilësia e legjislacionit e vështirëson zbatimin e tij. Prandaj, vlerësimi nëse ligji është i zbatueshëm në praktikë përpara miratimit të tij, si dhe kontrolli *a posteriori* nëse ai mund zbatohet në mënyrë efektive është shumë i rëndësishëm. Kjo do të thotë se duhet të bëhet vlerësim *ex ante* dhe *ex post* i legjislacionit kur trajtohet çështja e sundimit të ligjit.

55. Zbatimi i duhur i legjislacionit mund të pengohet edhe nga mungesa e sanksioneve të mjaftueshme (*lex imperfecta*), si dhe nga zbatimi i pamjaftueshëm ose selektiv i sanksioneve përkatëse.

8. Akterët privatë të ngarkuar me detyra publike

A garanton ligji që subjektet joshtetërore të cilat kanë marrë përsipër në tërësi apo pjesërisht detyra tradicionalisht publike, dhe veprimet e vendimet e të cilave kanë ndikim të ngjashëm me ato të autoriteteve publike mbi qytetarët e rëndomtë, u nënshtrohen kriterëve të sundimit të ligjit dhe japin llogari në mënyrë të krahasueshme me autoritetet publike?⁴⁰

56. Ka një sërë fushash ku akterët hibridë (publiko-privatë) ose subjektet private të cilët ushtrojnë kompetenca që tradicionalisht kanë qenë në domenin e autoriteteve shtetërore, përfshirë në fushat e menaxhimit të burgjeve dhe kujdesit shëndetësor. Sundimi i ligjit duhet të zbatohet edhe për situata të tilla.

40. Cf. Neni 124 i Kushtetutës së Finlandës: "Detyra publike administrative mund t'u delegohet të tjerëve përveç autoriteteve publike vetëm përmes një akti ose në bazë të një akti, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e duhur të detyrës dhe nëse nuk rrezikohen të drejtat dhe liritë themelore, mjetet juridike dhe kërkesat e tjera të qeverisjes së mirë".

B. Siguria Juridike

1. Qasja në legjislacion

A janë ligjet e qasshme?

- i. A publikohen të gjitha aktet legjislative përpara hyrjes së tyre në fuqi?
- ii. A janë ato lehtësisht të qasshme, *p.sh.* pa pagesë në internet dhe/ose në buletin zyrtar?

2. Qasja në vendime gjyqësore

A janë të qasshme vendimet e gjykatave?

- i. A janë vendimet e gjykatave lehtësisht të qasshme për publikun?⁴¹
- ii. A justifikohen mjaftueshëm përjashtimet?

57. Meqenëse vendimet e gjykatës mund të vendosin, shtjellojnë dhe qartësojnë ligje, qasja në to është pjesë e sigurisë juridike. Kufizimet mund të arsyetohen për të mbrojtur të drejtat individuale, për shembull ato të të miturve në rastet penale.

3. Parashikueshmëria e ligjeve

A janë të parashikueshme efektet e ligjeve?⁴²

- i. A janë shkruar ligjet në mënyrë të kuptueshme?
- ii. A përcakton qartë legjislacioni i ri nëse (dhe cili) legjislacioni i mëparshëm është shfuqizuar apo ndryshuar? A përfshihen ndryshimet në një version të konsoliduar të ligjit, të qasshëm për publikun?

58. Parashikueshmëria do të thotë jo vetëm që ligji, aty ku është e mundur,

41. GJEDNJ Fazlyiski kundër Bullgarisë, 40908/05, 16 prill 2013, §64-70, veçanërisht §65; Ryakib Biryukov kundër Rusisë, 14810/02, 17 janar 2008, në veçanti § 30ff; kf. Kononov kundër Letonisë, 36376/04, 17 maj 2010, § 185.

42. GJEDNJ The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr.1), 6538/74, 26 prill 1979, § 46ff; Rekvényi kundër Hungarisë, 25390/94, 20 maj 1999, § 34ff.

duhet të shpallet përpara zbatimit dhe të jetë i parashikueshëm për sa i përket efekteve të tij por që duhet gjithashtu të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme për t'u mundësuar subjekteve juridike të rregullojnë sjelljen e tyre në përputhje me të.⁴³

59. Megjithatë, shkalla e nevojshme e parashikueshmërisë varet nga natyra e ligjit. Kjo është veçanërisht thelbësore në legjislacionin penal. Masat paraprake para përballjes me rreziqe konkrete po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme; ky evolucion është legjitim për shkak të shumëfishimit të rreziqeve që burojnë sidomos nga ndryshimet teknologjike. Megjithatë, në fushat ku zbatohet qasja e masave paraprake të ligjeve, siç është ligji masave të rrezikut, parakushtet për veprimin e shtetit përshkruhen në terma që janë dukshëm më të gjera dhe më të pasakta, por sundimi i ligjit nënkupton që parimi i parashikueshmërisë të mos lihet mënjanë.

4. Stabiliteti dhe konsistenca e ligjit

A janë ligjet stabile dhe konsistente?

- i. A janë ligjet stabile në atë masë sa që ndryshohen vetëm me paralajmërim të qartë?⁴⁴
- ii. A aplikohen në mënyrë konsistente?

60. Mungesa e stabilitetit dhe e konsistencës në legjislacion ose veprime ekzekutive mund të ndikojë në aftësinë e një personi për t'i planifikuar veprimet e tij. Megjithatë, stabiliteti nuk është qëllim në vetvete: ligji duhet të jetë gjithashtu në gjendje t'u përshtatet ndryshimit të rrethanave. Ligji mund të ndryshohet, por me debat dhe njoftim publik, dhe pa ndikuar negativisht në pritshmëritë legjitime (shih pikën e radhës).

5. Pritshmëritë legjitime

A sigurohet respektimi i parimit të pritshmërive legjitime?

61. Parimi i pritshmërive legjitime është pjesë e parimit të përgjithshëm të sigurisë juridike në të drejtën e Bashkimit Evropian, që rrjedh nga të drejtat kombëtare. Ky parim gjithashtu shpreh idenë që autoritetet publike jo vetëm që duhet të respektojnë ligjin, por edhe premtimet e tyre dhe pritshmëritë e rritura. Sipas doktrinë të pritshmërisë legjitime, ata

43. The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (Nr. 1), 6538/74, 26 prill 1979, § 49.

44. Komisioni i Venedikut ka trajtuar çështjen e qëndrueshmërisë së legjislacionit në fushën zgjedhore: Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, CDL-AD(2002)023rev, II.2; Deklarata Interpretative për Stabilitetin e Ligjit Zgjedhor, CDL-AD(2005)043.

që veprojnë me mirëbesim në bazë të ligjit nuk duhet të zhgënjehen në pritshmëritë e tyre legjitime. Megjithatë, situatat e reja mund t'i justifikojnë ndryshimet legjislative që zhgënjnë pritshmëritë legjitime në raste përjashtimore. Kjo doktrinë zbatohet jo vetëm për legjislacionin, por edhe për vendimet individuale të autoriteteve publike.⁴⁵

6. Mosaplikimi prapaveprues i ligjeve

A ndalohet aplikimi prapaveprues i legjislacionit?

- i. A ndalohet aplikimi prapaveprues i legjislacionit penal?
- ii. Deri në çfarë mase ekziston ndalimi i përgjithshëm i veprimit prapaveprues të ligjeve tjera?⁴⁶
- iii. A ka përjashtime dhe, nëse po, në cilat kushte?

7. Parimi nullum crimen sine lege dhe nulla poena sine lege

A aplikohen parimet *nullum crimen sine lege* dhe *nulla poena sine lege* (nuk ka krim, nuk ka dënim pa ligj)?

62. Qytetarët duhet të informohen paraprakisht për pasojat e sjelljes së tyre. Kjo nënkupton parashikueshmëri (më sipër II.B.3) dhe mosaplikim prapaveprues të legjislacionit, veçanërisht të atij penal. Në të drejtën civile dhe atë administrative, aplikimi prapaveprues mund të ndikojë negativisht në të drejtat dhe interesat ligjore.⁴⁷ Megjithatë, jashtë fushës penale, mund

45. Për shembull, individët të cilët janë inkurajuar të përdorin një sjellje nga masat e punës në dobi të përgjithshme mund të presin në mënyrë legjitime që të mos i nënshtrohen kufizimeve që i prekin në mënyrë specifike, pas skadimit të kësaj sipërmarrjeje, pikërisht për shkak se kanë shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga dispozitat e punës në dobi të përgjithshme: GJED, 120/86, Mulder kundër Ministrisë të Bujqësisë dhe Peshkimit, 28 Prill 1988, § 21ff. Në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, doktrina e pritshmërive legjitime zbatohet në thelb për mbrojtjen e pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit të Parë Shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: shih. p.sh GJEDNJ Anhaeuser-Busch Inc. kundër Portugalisë [GC], 73049/01, 11 janar 2007, § 65; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke [GC] (dec.), 39794/98, 10 korrik 2002, § 68ff; National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society dhe Yorkshire Building Society kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21319/93, 21449/93, 21675/93, 21319/93, 21449/93 dhe 21675/93, 23 tetor 1997, § 62 eff.

46. Shih nenin 7.1 KEDNJ, Neni 15 ICCPR, Neni 9 ACHR, Neni 7.2 i Kartës Afrikane (Banjul) për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit [ACHPR] për të drejtën penale; Neni 28 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve për traktatet ndërkombëtare.

47. Parimi i mosretroaktivitetit nuk zbatohet kur legjislacioni i ri i vendos individët në një pozitë më të favorshme. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konsideron se neni 7 i KEDNJ përfshin parimin e retrospektivitetit të ligjit penal më të butë: shih Scoppola kundër Italisë (nr. 2), 10249/03, 17 shtator 2009.

të lejohet kufizimi prapaveprues i të drejtave të individëve ose vendosja e detyrimeve të reja, por vetëm nëse është në interesin publik dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit (përkohësisht). Ligjvënësi nuk duhet të ndërhyjë në zbatimin e legjislacionit ekzistues nga gjykatat.

8. Res judicata⁴⁸

A sigurohet respektimi i parimit *res judicata*?

- i. A respektohet parimi *ne bis in idem* (ndalimi i gjykimit të dyfishtë)?
- ii. A mund të rishikohen vendimet e plotfuqishme gjyqësore?
- iii. Nëse po, në cilat kushte?

63. *Res judicata* nënkupton që kur një ankimim është gjykuar me vendim të formës së prerë, nuk janë të mundshme ankime të mëtejshme. Aktgjykimet e formës së prerë duhet të respektohen, përveç nëse ka arsye bindëse për rishikimin e tyre.⁴⁹

48. Neni 4 Protokollit 7 KEDNJ, Neni 14.7 ICCPR, Neni 8.4 KEDNJ (në fushën penale); në respektimin e parimit të *res judicata*, Shiko p.sh GJEDNJ Brumărescu kundër Rumanisë, 28342/95, 28 tetor 1999, § 62; Kulkov dhe të tjerët kundër Rusisë, 25114/03, 11512/03, 9794/05, 37403/05, 13110/06, 19469/06, 42608/06, 44928/06, 44972/06 dhe 44972/06 dhe 2607/02 janar 4502 Duca kundër Moldavisë, 75/07, 3 mars 2009, § 32. Gjykata konsideron respektimin e *res judicata* si aspekt i sigurisë juridike. Cf. Marcus kundër Belgjikës, 6833/74, 13 qershor 1979, § 58.

49. Cf. Këshilli i Evropës dhe Sundimi i Ligjit - Përmbledhje, CM(2008)170, 21 nëntor 2008, § 4

C. Paradalimi dhe shpërdorimi i pushtetit⁵⁰

A ka garanci ligjore kundër arbitraritetit dhe shpërdorimit të pushtetit (*détournement de pouvoir*) nga autoritetet publike?

- i. Nëse po, cili është burimi ligjor i kësaj garancie (Kushtetuta, ligjet, praktika gjyqësore)?
- ii. A ka kufizime të qarta ligjore për pushtetin diskrecional, veçanërisht kur ushtrohet nga ekzekutivi në veprimet administrative?⁵¹
- iii. A ka mekanizma për parandalimin, korrigjimin dhe sanksionimin e shpërdorimit të kompetencave diskrecionale (*détournement de pouvoir*)? Kur pushteti diskrecional u jepet zyrtarëve, a ka rishikim gjyqësor të ushtrimit të një pushteti të tillë?
- iv. A obligohen autoritetet publike që të japin arsye adekuata për vendimet e tyre, veçanërisht kur ato prekin të drejtat e individëve? A është mosdeklarimi i arsyeve bazë e vlefshme për t'i kundërshtuar vendimet e tilla në gjykata?

64. Ushtrimi i pushtetit që çon në vendime materialisht të padrejta, të paarsyeshme, joracionale ose shtypëse, cenon sundimin e ligjit.

65. Diskrecioni i ekzekutivit për të pasur pushtet të pakufizuar është në kundërshtim me sundimin e ligjit. Rrjedhimisht, për të ofruar mbrojtje ndaj arbitraritetit, ligji duhet të përcaktojë fushëveprimin e çdo diskrecioni të tillë.

50. Mbrojtja kundër arbitraritetit u përmend nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në një sërë rastesh. Përveç atyre të cituara në shënimin vijues, shih p.sh. Husejini (Ebu Zubaydah) kundër Polonisë, 7511/13, 24 korrik 2014, § 521ff; Hassan kundër Mbretërisë së Bashkuar, 29750/09, 16 shtator 2014, § 106; Gjeorgjia kundër Rusisë (I), 13255/07, 3 korrik 2014, § 182ff (neni 5 KEDNJ); Ivinović kundër Kroacisë, 13006/13, 18 shtator 2014, § 40 (neni 8 KEDNJ). Për Gjykatën e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, shih p.sh. GJED, 46/87 dhe 227/88, Hoechst kundër Komisionit, 21 shtator 1989, § 19; T402/13, Orange kundër Komisionit Evropian, 25 nëntor 2014, § 89. Për kufijtë e kompetencave diskrecionale, shih Shtojcën e Rekomandimit të Komitetit i Ministrave për Administratën e Mirë, CM/Rec(2007)7, Neni 2.4 ("Parimi i ligjshmëria"): "[Autoritetet publike] do të ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm nëse vërtetohen faktet dhe ligji në fuqi u jep atyre të drejtën ta bëjnë këtë dhe vetëm për qëllimin për të cilin ata janë dhënë".

51. CM(2008)170, Këshilli i Evropës dhe sundimi i ligjit, § 46; GJEDNJ Malone, 8691/79, 2 gusht 1984, § 68; Segerstedt-Wiberg dhe të tjerët kundër Suedisë, 62332/00, 6 qershor 2006, § 76 (neni 8). Komplexiteti i shoqërisë moderne do të thotë që fuqia diskrecionale duhet tu jepet zyrtarëve publikë. Parimi sipas të cilit autoritetet publike duhet të përpiqen të jenë objektiv ("sachlich") në një numër shtetesh si Suedia dhe Finlanda shkon më tej se thjesht ndalimi i trajtimit diskriminues dhe shihet si faktor i rëndësishëm mbështetës besimi në administratën publike dhe kapitalin social.

66. Shpërdorimi i pushtetit diskrecional duhet të kontrollohet me anë të shqyrtimit gjyqësor ose ndonjë shqyrtimi tjetër të pavarur. Mjetet juridike në dispozicion duhet të jenë të qarta dhe lehtësisht të arritshme.

67. Mund të jetë gjithashtu e përshtatshme qasja te avokati i popullit ose ndonjë formë tjetër e juridiksionit jokontestimor.

68. Detyrimi për të dhënë arsyetim duhet të zbatohet edhe për vendimet administrative.⁵²

D. Barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi

1. Parimi

A është i mishëruar në Kushtetutë parimi i trajtimit të barabartë, angazhimit të shtetit për të promovuar barazinë dhe të drejtën e individëve për të qenë të lirë nga diskriminimi?

2. Mosdiskriminimi⁵³

A sigurohet respektimi i parimit të mosdiskriminimit?

- i. A e ndalon kushtetuta diskriminimin?
- ii. A garantohet mosdiskriminimi efektivisht me ligj?
- iii. A e përcakton dhe ndalon qartë Kushtetuta dhe/ose legjislacioni diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë?

69. Parimi i mosdiskriminimit kërkon ndalimin e çdo trajtimi të pajustificuar të pabarabartë sipas ligjit dhe/ose me ligj, dhe që të gjithë personat të kenë të garantuar mbrojtje të barabartë dhe efektive nga diskriminimi në baza të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare ose sociale, lidhja me ndonjë pakicë kombëtare, prona, lindja ose statusi tjetër.

52. Shih p.sh nenin 41.1.c të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Cf. po ashtu, pika II.E.2.c.vi dhe shënimi 126.

53. Shih, për shembull, nenin 14 të KEDNJ; Protokollin 12 të KEDNJ; nenet 12, 26 të PNDKP, nenin 24 të KADNP; neni i KADNP-së.

3. Barazia në ligj

A garantohet barazia në ligj?

- i. A kërkon kushtetuta që legjislacioni (përfshirë rregulloret) të respektojë parimin e barazisë në ligj? ⁵⁴A parasheh që diferencimet duhet të arsyetohen objektivisht?
- ii. A mund të kundërshtohet në gjykatë legjislacioni që cenon parimin e barazisë?
- iii. A ka individë apo grupe me privilegje të veçanta ligjore? A bazohen këto përjashtime dhe/ose privilegje në një qëllim legjitim dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit?
- iv. A parashihen shprehimisht masa pozitive në dobi të grupeve të veçanta, përfshirë pakicat kombëtare, për të adresuar pabarazitë strukturore?

70. Legjislacioni duhet të respektojë parimin e barazisë: ai duhet të trajtojë situata të ngjashme në mënyrë të barabartë dhe situata të ndryshme në mënyra të ndryshme, dhe të garantojë barazi në lidhje me çdo bazë të mundshme diskriminimi.

71. Për shembull, rregullat për imunitetin parlamentar dhe, më konkretisht, paprekshmërinë, “duhet ... të rregullohen në mënyrë restriktive dhe duhet të jetë gjithmonë e mundur që imuniteti i tillë të hiqet duke ndjekur procedura të qarta dhe të paanshme. Nëse zbatohet, paprekshmëria duhet të hiqet përveç në rastet kur justifikohet në lidhje me çështjen në fjalë dhe është proporcionale dhe e domosdoshme për të mbrojtur funksionimin demokratik të parlamentit dhe të drejtat e opozitës politike”.⁵⁵

72. “Ligji duhet të përcaktojë që ndalimi i diskriminimit nuk pengon mbajtjen ose miratimin e masave të përkohshme të veçanta të destinuara qoftë për parandalimin ose kompensimin e disavantazheve që vuajnë personat për shkak [të përkatësisë në një grup të caktuar], ose për mundësimin e pjesëmarrjes së plotë në të gjitha fushat e jetës. Këto masa nuk duhet të vazhdohen pasi të jenë arritur objektivat e synuara”.⁵⁶

54. Cf. p.sh CDL-AD(2014)010, § 41-42; CDL-AD(2013)032, Opinion mbi draftin përfundimtar të Kushtetutës së Republikës së Tunizisë, § 44ff: barazia nuk duhet të kufizohet vetëm te shtetasit dhe të përfshijë një klauzolë të përgjithshme lidhur me mosdiskriminimin.

55. CDL-AD (2014)011, Raport për fushëveprimin dhe heqjen e imuniteteve parlamentare (§ 200); GJEDNJ Cordova kundër Italisë, nr. 1 dhe nr.2, 40877/98 dhe 45649/99, 30 janar 2003, § 58-67.

56. KERJ (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Mosdurimit). Rekomandimi nr. 7, § 5.

4. Barazia para ligjit

A garantohet barazia para ligjit?

- i. A përcakton qartë rendi juridik kombëtar se ligji zbatohet në mënyrë të barabartë për çdo person, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare ose sociale, lidhja me një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose statusi?⁵⁷ A përcakton që diferencimet duhet të arsyetohen në mënyrë objektive, mbi bazën e një qëllimi të arsyeshëm dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit?⁵⁸
- ii. A ka mjet efektiv juridik kundër zbatimit diskriminues ose të pabarabartë të legjislacionit?⁵⁹

73. Sundimi i ligjit kërkon nënshtrimin universal të të gjithëve ndaj ligjit. Kjo nënkupton që ligji duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë dhe konsistente. Megjithatë, barazia nuk është thjesht një kriter formal, por duhet të rezultojë në trajtim substancialisht të barabartë. Për të arritur këtë qëllim, mund të jetë e nevojshme që të tolerohen, madje edhe të kërkojnë, diferencimet. Për shembull, veprimi afirmativ mund të jetë, në rrethana të kufizuara, një mënyrë për të siguruar barazi thelbësore me qëllim që të korrigjohen disavantazhet ose përjashtimet nga e kaluara.⁶⁰

57. Për shembull, neni 1.2 i Protokollit 12 të KEDNJ-së e bën të qartë se “çdo autoritet publik” - dhe jo vetëm ligjvënësi - duhet të respektojë parimin e barazisë. Neni 26 i PNDKP-së parasheh që “Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit”. “Parimi i trajtimit të barabartë është një parim i përgjithshëm i së drejtës së Bashkimit Evropian, i sanksionuar në nenet 20 dhe 21 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian”: GJED, C-550/07 P, *Akzo Nobel Chemicals dhe Akros Chemicals kundër Komisionit*, 14 shtator 2010, § 54.

58. Një dallim është i pranueshëm nëse situatat nuk janë të krahasueshme dhe/ose nëse bazohet në një arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm: Shih GJEDNJ *Hämäläinen kundër Finlandës*, 37359/09, 26 korrik 2014, § 108: “Gjykata ka përcaktuar në praktikën e saj gjyqësore se në mënyrë që të lindë një çështje sipas nenit 14 duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata përkatësisht të ngjashme. Një dallim i tillë në trajtim është diskriminues nëse nuk ka arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm; me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Shtetet Kontraktuese gëzojnë një liri veprimi në vlerësimin nëse dhe në çfarë mase dallimet në situata të ngjashme arsyetojnë ndryshimin në trajtim (shih *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* GC, nr. 13378/05, § 60, GJEDNJ 2008)”.

59. Cf. neni 13 KEDNJ; neni 2.3 KNDKP; neni 25 KADNJ; neni 7.1.a KADNPJ.

60. Cf. Neni 1.4 dhe 2.2 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KNEFDR); neni 4 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEFDG); neni 5.4 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK).

E. Qasja në drejtësi⁶¹

1. Pavarësia dhe paanshmëria

a. Pavarësia e gjyqësorit

A ka garanci të mjaftueshme kushtetuese dhe ligjore për pavarësinë e gjyqësorit?

- i. A janë të përcaktuara në Kushtetutë apo në legjislacionin e zakonshëm parimet themelore të pavarësisë së gjyqësorit, duke përfshirë procedurat dhe kriteret objektive për emërimet në gjyqësor, mandatin, disiplinën dhe shkarkimet?⁶²
- ii. A emërohen gjyqtarët përjetësisht apo deri në moshën e pensionit? A janë arsyet për largim të kufizuara në shkelje të rënda të dispozitave disiplinore ose penale të përcaktuara me ligj, apo në rastet kur gjyqtari nuk mund t'i ushtrojë më funksionet gjyqësore? A është e përcaktuar qartë me ligj procedura që zbatohet për shkarkim? A kanë gjyqtarët individualë në dispozicion mjete juridike kundër vendimit për shkarkim?⁶³
- iii. A janë të përcaktuara qartë arsyet për masat disiplinore dhe a janë sanksionet të kufizuara në shkeljet e qëllimshme dhe pakujdesi të rëndë?⁶⁴
- iv. A është ndonjë organ i pavarur përgjegjës për këto procedura?⁶⁵
- v. A është ky organ i përbërë vetëm nga gjyqtarë?
- vi. A bazohet emërimi dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve në faktorë përkatës si aftësia, integriteti dhe përvoja?⁶⁶ A janë këto kriterë të përcaktuara me ligj?

61. Për çështjen e qasjes në drejtësi dhe sundimin e ligjit, shih SG/Inf(2016)3, Sfdat për pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Raporti i përgatitur së bashku nga Byroja e CCJE-së dhe Byroja i CCPE për vëmendjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës si vazhdim i raportit të tij të vitit 2015 me titull *"Gjendja e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit në Evropë – një përgjegjësi e përbashkët për sigurinë demokratike në Evropë"*.

62. CDL-AD(2010)004, § 22: "Parimet bazë që sigurojnë pavarësinë e gjyqësorit duhet të përcaktohen në Kushtetutë ose në tekste ekuivalente".

63. Cf. CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, § 49ff; CDL-AD(2010)004, § 33ff; për drejtësinë kushtetuese, shih "Përbërja e Gjykatave Kushtetuese", Shkenca dhe Teknika e Demokracisë nr. 20, CDL-STD(1997)020, f. 18-19.

64. "Gjyqtarët... duhet të gëzojnë imunitet funksional – por vetëm funksional – (imunitet nga ndjekja penale për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, me përjashtim të krimeve të qëllimshme, p.sh. marrja e ryshfetit)": CDL-AD(2010)004, § 61.

65. Rekomandimet e OSBE-së në Kiev për Pavarësinë e Gjyqësorit, § 9.

66. CM/Rec(2010)12, § 44.

- vii. Në cilat kushte është i mundur transferimi i gjyqtarëve në një gjykatë tjetër? A kërkohet pëlqimi i gjyqtarit për transferimin? A mund ta apelojë gjyqtari vendimin për transferim?
- viii. A ka këshill të pavarur gjyqësor? A është i bazuar në Kushtetutë apo në ligjin për gjyqësorin?⁶⁷ Nëse po, a siguron përfaqësim adekuat të gjyqtarëve, avokatëve dhe publikut?⁶⁸
- ix. A mund të ankohen gjyqtarët në këshill gjyqësor për shkelje të pavarësisë së tyre?
- x. A garantohet autonomia financiare e gjyqësorit? Në veçanti, a ndahen burime të mjaftueshme gjykatave dhe a ka ndonjë nen të veçantë në buxhet që ka të bëjë me gjyqësorin, që përjashton mundësinë e reduktimeve nga ekzekutivi, përveç nëse kjo bëhet me masë të përgjithshme të kompensimit?⁶⁹ A jep kontribut gjyqësori apo këshilli gjyqësor në procesin buxhetor?
- xi. A janë të kufizuara detyrat e prokurorëve kryesisht në fushën e drejtësisë penale?⁷⁰
- xii. A perceptohet gjyqësori si i pavarur? Cili është perceptimi i publikut për ndikimet apo manipulimet e mundshme politike në emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve/prokurorëve, si dhe për vendimet e tyre në raste individuale? A i mbron këshilli gjyqësor, nëse ka të tillë, në mënyrë efektive gjyqtarët kundër sulmeve të papërshtatshme?
- xiii. A i përcjellin gjyqtarët sistematikisht kërkesat e prokurorëve (“anshmëria prokuroriale”)?
- xiv. A janë pagat e gjyqtarëve të drejta dhe të mjaftueshme?

74. Gjyqësori duhet të jetë i pavarur. Pavarësia do të thotë që gjyqësori të jetë i lirë nga trysnitë e jashtme dhe të mos u nënshtrohet ndikimeve apo manipulimeve politik, sidomos të ekzekutivit. Ky kriter është pjesë përbërëse e parimit themelor demokratik të ndarjes së pushteteve. Gjyqtarët nuk duhet t’i nënshtrohen ndikimit apo manipulimit politik.

67. Komisioni i Venedikut e konsideron të përshtatshme krijimin e një Këshilli Gjyqësor që ka ndikim vendimtar në vendimet për emërimin dhe karrierën e gjyqtarëve: CDL-AD (2010) 004, § 32.

68. “Një përbërje substanciale ose shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor duhet të zgjidhen nga vetë Gjyqësori”: CDL-AD(2007)028, § 29.

69. CDL-AD(2010)038, Parashtresa Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të “ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë” për ndryshimin e disa ligjeve që kanë të bëjnë me sistemin e pagave dhe shpërblimeve të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar.

70. Rekomandimi CM/Rec(2012)11 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi rolin e prokurorëve publikë jashtë sistemit të drejtësisë penale; CDL-AD(2010)040, § 81-83; CDL-AD(2013)025, Opinion i Përbashkët mbi projektligjin për prokurorinë publike të Ukrainës, § 16-28.

75. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut i thekson katër elementë të pavarësisë së gjyqësorit: mënyrën e emërimit, mandatin, ekzistencën e garancive ndaj presionit të jashtëm, përfshirë në çështjet buxhetore, dhe nëse gjyqësori shfaqet si i pavarur dhe i paanshëm.⁷¹

76. Mandatet e kufizuara ose të ripërtërishme mund të shpijnë në vartësi të gjyqtarëve nga autoriteti që i ka emëruar ose ka fuqinë për t'i riemëruar ata.

77. Legjislacioni për shkarkimin e gjyqtarëve mund të inkurajojë sanksione të maskuara.

78. Shkeljet që çojnë në sanksione disiplinore dhe pasojat e tyre ligjore duhet të përcaktohen qartë me ligj. Sistemi disiplinor duhet t'i plotësojë kriteret e drejtësisë procedurale përmes dëgjimit të drejtë dhe mundësisë së apelimit(ve) (shih pjesën II.E.2 më poshtë).

79. Është e rëndësishme që emërimi dhe ngritja në detyrë e gjyqtarëve të mos bazohet në konsiderata politike ose personale, dhe që sistemi të monitorohet vazhdimisht për të siguruar këtë gjë.

80. Megjithëse transferimi i gjyqtarëve pa pëlqimin e tyre në një gjykatë tjetër në disa raste mund të zbatohet ligjërisht si sanksion, ai mund të përdoret edhe si lloj mjeti i motivuar politikisht nën maskimin e sanksionit.⁷² Sidoqoftë, transferimi i tillë justifikohet në parim në rastet e riorganizimit legjitim institucional.

81. "[Ë]shtë metodë e përshtatshme për garantimin e pavarësisë së gjyqësorit që një këshill i pavarur gjyqësor të ketë ndikim vendimtar në vendimet për emërimin dhe karrierën e gjyqtarëve". Këshillat gjyqësorë "duhet të kenë përbërje pluraliste me një pjesë të konsiderueshme, në mos shumicën, të anëtarëve që janë gjyqtarë".⁷³ Kjo është mënyra më efektive për të siguruar që vendimet në lidhje me përzgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve të jenë të pavarura nga qeveria dhe administrata.⁷⁴ Megjithatë, mund të ketë mënyra të tjera të pranueshme për të emëruar një gjyqësor të pavarur.

82. Dhënia e një roli të tillë ekzekutivit është e lejueshme vetëm në shtetet ku këto kompetenca kufizohen nga kultura dhe traditat juridike, të cilat janë pjekur për një kohë të gjatë, kurse përfshirja e parlamentit bart rrezikun

71. Shih veçanërisht GJEDNJ *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 qershor 2014, 7819/77, dhe 7878/77, § 78.

72. Cf CDL-AD(2010)004, § 43.

73. CDL-AD(2010)004, § 32.

74. Cf. Rekomandimi (94)12 i Komitetit të Ministrave për Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve (Parimi I.2.a), i cili pasqyron një preferencë për një këshill gjyqësor, por pranon edhe sisteme të tjera.

e politizimit.⁷⁵ Përfshirja vetëm e gjyqtarëve bart rrezikun e krijimit të një perceptimi të vetëmbrojtjes, interesit vetjak dhe favorizimit të miqve. Për sa i përket përbërjes së këshillit gjyqësor, duhet shmangur si politizimi ashtu edhe korporatizmi.⁷⁶ Duhet të gjendet një ekuilibër i duhur ndërmjet gjyqtarëve dhe anëtarëve jogjyqtarë.⁷⁷ Përfshirja e degëve të tjera të pushtetit nuk duhet të paraqesë rrezik për presionit të papërshtatshëm ndaj anëtarëve të Këshillit dhe gjyqësorit në tërësi.⁷⁸

83. Resurset e mjaftueshme janë thelbësore për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit nga institucionet shtetërore dhe palët private, në mënyrë që gjyqësori të mund t'i kryejë detyrat e tij me integritet dhe efikasitet, duke nxitur kështu besimin e publikut në drejtësi dhe në sundimin e ligjit.⁷⁹ Dhënia e mundësisë që pushteti ekzekutiv të reduktojë buxhetin e gjyqësorit është një shembull se si resurset e gjyqësorit mund të vihen nën presion të papërshtatshëm.

84. Prokuroria publike nuk duhet të lejohet të ndërhyjë në çështjet gjyqësore jashtë rolit të saj standard në sistemin e drejtësisë penale, p.sh. sipas modelit të "Prokuraturës". Një pushtet i tillë do të vinte në pikëpyetje punën e gjyqësorit dhe do të rrezikonte pavarësinë e tij.⁸⁰

85. Kriteret xii-xiv kanë të bëjnë para së gjithash me perceptimin e pavarësisë së gjyqësorit. Anshmëria prokuroriale është një shembull i mungesës së pavarësisë, që mund të inkurajohet nga mundësia e sanksioneve në rast të aktgjytimeve "të gabuara". Në fund, pagat e drejta dhe të mjaftueshme janë aspekt konkret i autonomisë financiare të gjyqësorit. Ato janë mjet për të parandaluar korrupsionin, i cili mund të rrezikojë pavarësinë e gjyqësorit jo vetëm nga degët e tjera të pushtetit, por edhe nga individët.⁸¹

75. CDL-AD(2007)028, Raporti mbi Emërimet në Gjyqësorë, § 44 ff. Tendanca në vendet e Commonwealth-it është larg emërimeve nga ekzekutivi dhe drejt komisioneve të emërimeve, të njohura ndonjëherë si komisione të shërbimeve gjyqësore. Shih J. van Zyl Smit (2015), Emërimi, mandati dhe largimi i gjyqtarëve sipas Parimeve të Commonwealth-it: Një përmbledhje dhe analizë e praktikës më të mirë (Raporti i Huluntimit i ndërmarrë nga Qendra Bingham për Sundimin e Ligjit), në dispozicion në http://www.biicl.org/documents/689_bing-ham_centre_compendium.pdf.

76. Shih CDL-PI(2015)001, Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venedikut lidhur me Gjykatat dhe Gjyqtarët, ch. 2.4, dhe referencat.

77. Shih CDL-PI(2015)001, Përmbledhja e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venedikut në lidhje me Gjykatat dhe Gjyqtarët, kap. 4.2 dhe referencat.

78. CDL-INF(1999)005, Opinioni mbi reformën e gjyqësorit në Bullgari, § 28; Shih gjithashtu, p.sh, CDL-AD(2007) draft, Raporti mbi Emërimet në Gjyqësorë nga Komisioni i Venedikut, § 33; CDL-AD(2010)026, Opinioni i përbashkët mbi projektligjin për sistemin gjyqësor dhe statusin e gjyqtarëve të Ukrainës, § 97, në lidhje me praninë e ministrave në këshillin gjyqësor.

79. CM/Rec(2010)12, § 33ff; CDL-AD(2010)004, § 52ff.

80. CDL-AD(2010)040, § 71ff.

81. Cf. CDL-AD(2012)014, Opinioni mbi Sigurinë Juridike dhe Pavarësinë e Gjyqësorit në Bosnjë dhe Hercegovinë, § 81.

b. Pavarësia e gjyqtarëve individualë

A ka garanci të mjaftueshme kushtetuese dhe ligjore për pavarësinë e gjyqtarëve individualë?

- i. A i nënshtrohen veprimtaritë gjyqësore mbikëqyrjes së gjykatave më të larta – jashtë kuadrit të ankesës – nga kryetarët e gjykatave, ekzekutivi apo organe të tjera publike?
- ii. A garanton Kushtetuta të drejtën për gjyqtar kompetent (“gjyqtar fizik i përcaktuar me ligj”)?⁸²
- iii. A e përcakton ligji qartë se cila gjykatë është kompetente? A vendosë rregulla për të zgjidhur konfliktin e kompetencave?
- iv. A bëhet ndarja e lëndëve sipas kriterëve objektive dhe transparente? A përjashtohet tërheqja e gjyqtarit nga një rast përveç kur kjo është bërë bazuar në kërkesën për përjashtim nga njëra nga palët ose nga vetë gjyqtari?⁸³

86. Pavarësia e gjyqtarëve individualë duhet të sigurohet sikundër pavarësia e gjyqësorit nga legjislativi dhe, në veçanti, ekzekutivi.

87. Mundësia e ankimimit të vendimeve në gjykatë më të lartë është element i zakonshëm në sistemet gjyqësore dhe duhet të jetë mënyra e vetme e shqyrtimit të gjyqtarëve gjatë zbatimit të ligjit. Gjyqtarët nuk duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes nga kolegët e tyre gjyqtarë, e aq më pak nga pushteti ekzekutiv hierarkik që ushtrohet për shembull nga nëpunësit civilë. Mbikëqyrja e tillë do të binte ndesh me pavarësinë e tyre individuale dhe, rrjedhimisht, do të cenonte sundimin e ligjit.⁸⁴

88. “Garancia mund të kuptohet në dy aspekte, ku njëri ka të bëjë me gjykatën në tërësi, ndërkaq tjetri me gjyqtarin individual ose trupin gjykues që merret me çështjen. Nuk mjafton vetëm të caktohet paraprakisht gjykata (ose dega gjyqësore) kompetente për një çështje të caktuar. Është thelbësore që të caktohet paraprakisht radha e gjyqtarëve individualë (ose trupit gjykues) të një gjykate, pra të bazohet në parime të përgjithshme objektive”.⁸⁵

82. CDL-AD(2010)004, § 78; Shih p.sh Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, Zand kundër Austrisë, 7360/76, 16 maj 1977, D.R. 8, f. 167; GJEDNJ *Frani kundër Sllovakisë*, 8014/07, 21 qershor 2011, § 134ff.

83. Për ndarjen e lëndëve, shih CM/Rec(2010)12, § 24; CDL-AD(2010)004, § 73ff. Rekomandimet e OSBE-së në Kiev përmendin si praktikë të mirë ose caktimin e rastësishëm të rasteve ose caktimin e bazuar në kriterë të paracaktuara, të qarta dhe objektive (§ 12).

84. CM/Rec(2010)12, § 22ff; CDL-AD(2010)004, § 68ff; CM/Rec(2000)19 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi rolin e prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë penale, § 19; CDL-AD(2010)004, Raporti mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve), § 72.

85. CDL-AD(2010)004, § 79.

c. Paanshmëria e gjyqësorit⁸⁶

A ka rregulla specifike kushtetuese dhe ligjore që parashohin paanshmërinë e gjyqësorit?⁸⁷

- i. Cili është perceptimi i publikut për paanshmërinë e gjyqësorit dhe të gjyqtarëve individualë?
- ii. A ka korrupsion në drejtësi? A ekzistojnë masa specifike kundër korrupsionit në gjyqësor (*p.sh.* deklarimi i pasurisë)? Cili është perceptimi i publikut për këtë çështje?⁸⁸

89. Paanshmëria e gjyqësorit duhet të sigurohet si në praktikë ashtu edhe në ligj. Formula klasike, siç shprehet për shembull nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është se “drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe të shihet se po zbatohet”.⁸⁹ Kjo nënkupton paanshmëri si objektive ashtu edhe subjektive. Perceptimi i publikut mund të ndihmojë në vlerësimin nëse gjyqësori është i paanshëm në praktikë.

90. Deklarimi i pasurisë është mjet për luftimin e korrupsionit ngaqë mund të nxjerrë në pah çdo konflikt interesi dhe mund të çojë në shqyrtimin e çdo të ardhure të pazakontë⁹⁰.

d. Shërbimi i prokurorisë: autonomia dhe kontrolli

A sigurohet autonomi e mjaftueshme e prokurorisë?

- i. A ka prokuroria publike autonomi të mjaftueshme në kuadër të strukturës shtetërore? A vepron në bazë të ligjit dhe jo në bazë të konvenimit politik?⁹¹
- ii. A lejohet që ekzekutivi t’i japë prokurorisë udhëzime specifike për raste të veçanta? Nëse po, a janë ato të arsyetuara me shkrim dhe a i nënshtrohen kontrollit nga publiku?⁹²

86. Neni 6.1 KEDNJ; neni 14.1 KNDCP; neni 8.1 KADNJ; neni 7.1.d KADNJP. Shih gjithashtu aspektet e ndryshme të paanshmërisë në parimet e Bangalore të sjelljes gjyqësore, Vlera 2, duke përfshirë mungesën e favorizimit, njëanshmërisë ose paragjykitimit.

87. Shih *p.sh.* GJEDNJ *Micallef v. Malta* [GC], 17056/06, 15 tetor 2009, § 99-100.

88. Për korrupsionin, shih në përgjithësi II.F.1.

89. Shih *p.sh.* GJEDNJ *DeCubber kundër Belgjikës*, 9186/80, 26 tetor 1984, § 26; *Micallef kundër Maltës*, 17056/06, 15 tetor 2009, § 98; *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, 21722/11, 9 janar 2013, § 106.

90. CDL-AD(2011)017, Opinioni mbi vënien në zbatim të ndryshimeve në ligjin kushtetues “për statusin e gjyqtarëve” të Kirgistanit, § 15.

91. Shih në veçanti CM/Rec(2000)19, § 11ff; CDL-AD(2010)040, § 23ff.

92. Cf CDL-AD(2010)040, § 22

- iii. A mundet një prokuror i lartë t'i japë udhëzime të drejtpërdrejta një prokurori më të ulët për një çështje të caktuar? Nëse po, a arsyetohen ato dhe a janë në formë të shkruar?
- iv. A ka ndonjë mekanizëm me të cilin një prokuror i ri mund ta kundërshtojë vlefshmërinë e udhëzimit duke u thirrur në karakterin e paligjshëm ose arsyet pa vend të udhëzimit?
- v. Gjithashtu, a mundet prokurori që konteston vlefshmërinë e udhëzimit të kërkojë që të zëvendësohet?⁹³
- vi. A është e lejueshme ndërprerja e mandatit vetëm kur prokurorët mbushin moshën e pensionitose për qëllime disiplinore apo përndryshe, prokurorët emërohen për periudhë relativisht të gjatë kohore pa mundësi riemërimi?⁹⁴
- vii. A janë të përcaktuara qartë me ligj këto çështje dhe arsyet për shkarkimin e prokurorëve?⁹⁵
- viii. A ka mjete juridike për prokurorin individual kundër vendimit të shkarkimit?⁹⁶
- ix. A bazohet emërimi, transferimi dhe ngritja në detyrë e prokurorëve në faktorë objektivë, veçanërisht në aftësi, integritet dhe përvojë, dhe jo në konsiderata politike? A janë të përcaktuara me ligj parimet e tilla?
- x. A janë pagat e prokurorëve të drejta dhe të mjaftueshme?⁹⁷
- xi. A ekziston perceptimi se politikat prokuroriale mundësojnë zbatimin selektiv të ligjit?
- xii. A i nënshtrohet veprimi prokurorial kontrollit gjyqësor?

91. Nuk ekziston ndonjë standard i përgjithshëm për organizimin e shërbimit prokurorial, veçanërisht për sa i përket autoritetit për emërimin e prokurorëve publikë apo për organizimin e brendshëm të shërbimit të prokurorisë publike. Megjithatë, duhet të sigurohet autonomi e mjaftueshme për t'i mbrojtur autoritetet prokuroriale nga ndikimi i papërshtatshëm politik. Në përputhje me parimin e ligjshmërisë, prokuroria publike duhet të veprojë vetëm në bazë të ligjit dhe në përputhje me të.⁹⁸ Kjo nuk e pengon ligjin që t'u japë autoriteteve prokuroriale njëfarë diskrecioni kur vendosin nëse do të fillojnë një procedurë penale apo jo (parimi i opor-

93. Cf CDL-AD(2010)040, § 53ff.

94. CDL-AD(2010)040, § 34ff, 47ff.

95. CDL-AD(2010)040, Raporti mbi Standardet Evropiane në lidhje me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor: Pjesa II - Shërbimi prokurorial, § 39.

96. CDL-AD(2010)040, § 52.

97. CDL-AD(2010)040, § 69.

98. Shih II.A.1.

tunitetit).⁹⁹

92. Pavarësia duhet të sigurohet edhe brenda prokurorisë. Prokurorët nuk duhet t'u nënshtrohen udhëzimeve të rrepta hierarkike pa asnjë diskrecion dhe duhet të jenë në gjendje të mos zbatojnë udhëzime që bien ndesh me ligjin.

93. Shqetësimet në lidhje me gjyqësorin vlejné përshtatshmërisht edhe për prokurorinë, përfshirë rëndësinë e vlerësimit të rregulloreve ligjore si dhe praktikës.

94. Edhe në këtë rast¹⁰⁰, kompensimi i mjaftueshëm është element i rëndësishëm i pavarësisë dhe garanci kundër korrupsionit.

95. Njëanshmëria e shërbimeve të prokurorisë publike mund të çojë në ndjekje penale jo të duhur, ose në ndjekje penale selektive, veçanërisht të atyre që janë në pushtet ose afër tyre. Kjo do të rrezikonte zbatimin e sistemit ligjor dhe për rrjedhojë përbën rrezik për sundimin e ligjit. Perceptimi publik është thelbësor në identifikimin e një paragjykimi të tillë.

96. Ashtu si në fushat tjera, ekzistenca e një mjeti juridik të hapur për individët, të drejtat e të cilëve janë prekur, është thelbësore për të garantuar respektimin e sundimit të ligjit.

e. Pavarësia dhe paanshmëria e Odës

A është e siguar pavarësia dhe paanshmëria e Odës së Avokatëve?

- i. A ekziston profesioni ligjor i njohur, i organizuar dhe i pavarur (Oda e Avokatëve)?¹⁰¹
- ii. A ka bazë ligjore për funksionimin e Odës së Avokatëve, bazuar në parimet e pavarësisë, konfidencialitetit dhe etikës profesionale, si dhe shmangies së konfliktit të interesit?
- iii. A është qasja në Odën e Avokatëve e rregulluar në mënyrë objektive dhe mjaftueshëm të hapur, edhe për sa i përket shpërbimit dhe ndihmës juridike?
- iv. A ekzistojnë procedura disiplinore efektive dhe të drejta në Odën e Avokatëve?
- v. Cili është perceptimi i publikut për pavarësinë e Odës së Avokatëve?

97. Oda e Avokatëve luan rol themelor në asistimin e sistemit gjyqësor.

⁹⁹. CDL-AD(2010)040, § 7, 53ff.

¹⁰⁰. Shih II.E.1.a.xiv për gjyqtarët.

¹⁰¹. Shih Rekomandimin nr. R(2000)21 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit

Prandaj është thelbësore që ajo të organizohet në mënyrë që të sigurojë pavarësinë dhe funksionimin e duhur. Kjo nënkupton që legjislacioni parasheh tiparet kryesore të pavarësisë së saj dhe që qasja në Odën e Avokatëve të jetë mjaftueshëm e hapur për ta bërë efektive të drejtën për avokat. Procedurat penale dhe disiplinore efektive dhe të drejta janë të nevojshme për të garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e avokatëve.

98. Etika profesionale nënkupton mes tjerash që “avokati duhet të ruajë pavarësinë dhe të gëzojë mbrojtjen që i ofron pavarësia e tillë për t’u dhënë klientëve këshilla dhe përfaqësim të paanshëm”¹⁰². Ai ose ajo “ruan gjithmonë standardet më të larta të ndershmërisë, integritetit dhe paanshmërisë në raport me klientët, gjykatën, kolegët dhe të gjitha palët me të cilat ka kontakt profesional”,¹⁰³ “nuk merr qëndrim në të cilin interesat e klientit bien ndesh me ato të avokatit”¹⁰⁴ dhe “trajton interesin e klientit si parësor”.¹⁰⁵

102. Oda Ndërkombëtare e Avokatëve – Parimet Ndërkombëtare të Sjelljes për Profesionin Juridik.1.1

103. Po aty., 2.1.

104. Po aty., 3.1.

105. Po aty., 5.1.

2. Gjykimi i drejtë¹⁰⁶

a. Qasja në gjykata

A kanë individët qasje efektive në gjykata?

- i. *Locus standi* (e drejta për të ngritur padi): A kanë individët mundësi lehtë të qasshme dhe efektive për të kontestuar një akt privat ose publik që ndërhyr në të drejtat e tij/saj?¹⁰⁷
- ii. A garantohet e drejta për mbrojtje, duke përfshirë ndihmën juridike efektive?¹⁰⁸ Nëse po, cili është burimi ligjor i kësaj garancie?
- iii. A është e qasshme ndihma juridike për palët që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike, kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë?¹⁰⁹
- iv. A janë kriteret formale¹¹⁰, afatet¹¹¹ dhe tarifat gjyqësore të arsyeshme?¹¹²

106. Neni 6 KEDNJ, Neni 14 KNDNJ, Neni 8 KEDNJ, Neni 7 KEDNJ. E drejta për një gjykim të drejtë u njoh nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, si “e frymëzuar nga neni 6 i KEDNJ”: C-174/98 P dhe C-189/98 P, *Holandë dhe Van der Wal kundër Komisionit*, 11 janar 2000, §17. Shih tani nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore

107. “Shkalla e qasjes së ofruar nga legjislati kombëtar duhet të jetë gjithashtu e mjaftueshme për të siguruar “të drejtën për gjykatë” të individit, duke pasur parasysh parimin e sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike. Që e drejta e qasjes të jetë efektive, një individ duhet të ketë një mundësi të qartë dhe praktike për të kundërshtuar një akt që është një ndërhyrje në të drejtat e tij”, *GJEDNJ Bellet kundër Francës*, 23805/94, 4 dhjetor 1995, § 36; kf. *GJEDNJ MD dhe të tjerët kundër Maltës*, 64791/10, 17 korrik 2012, § 53.

108. Neni 6.3.bc KEDNJ, neni 14.3 ICCPR; Neni 8.2 KEDNJ; e drejta për mbrojtje mbrohet nga neni 6.1 i KEDNJ në procedurat civile, shih p.sh. *GJEDNJ Oferta Plus SRL kundër Moldavisë*, 14385/04, 19 dhjetor 2006, § 145. Ajo njihet në përgjithësi nga neni 7.1.c i KKSHPR-së.

109. Neni 6.3.c KEDNJ, neni 14.3.d i KNDNJ për procedurat penale; e drejta për ndihmë juridike parashikohet deri në një masë nga neni 6.1 i KEDNJ-së për procedurat civile: shih p.sh. *GJEDNJ A. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 35373/97, 17 dhjetor 2002, § 90ff; për gjykatat kushtetuese në veçanti, shih CDL-AD(2010)039rev, Studimi për qasjen individuale në drejtësinë kushtetuese, § 113

110. Për drejtësinë kushtetuese, shih CDL-AD(2010)039rev, § 125.

111. Për drejtësinë kushtetuese, shih CDL-AD(2010)039rev, § 112; për afatet kohore për marrjen e vendimit, shih § 149.

112. Për tarifat e tepërta gjyqësore, shih p.sh. *GJEDNJ Kreuz kundër Polonisë (nr. 1)*, 28249/95, 19 qershor 2001, § 60-67; *Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë*, 63945/00, 24 maj 2006, § 32ff; *Scordino kundër Italisë*, 36813/97, 29 mars 2006, § 201; *Sakhnovskiy kundër Rusisë*, 21272/03, 2 nëntor 2010, § 69; për sigurinë e tepruar për kostot, shih p.sh. *GJEDNJ Ait-Mouhoub kundër Francës*, 22924/93, 28 tetor 1998, § 57-58; *Garcia Manibardo kundër Spanjës*, 38695/97, 15 shkurt 2000, § 38-45; për drejtësinë kushtetuese, shih CDL-AD(2010)039rev, § 117.

- v. A është e lehtë qasja në drejtësi në praktikë?¹¹³ Çfarë masash merren për ta bërë më të lehtë?
- vi. A është i disponueshëm për publikun informacioni i duhur për funksionimin e gjyqësorit?

99. Individët zakonisht nuk janë në gjendje të inicojnë vetë procedurat gjyqësore. Prandaj, ndihma juridike është thelbësore dhe duhet të jetë e disponueshme për të gjithë. Ndiurma juridike duhet t'u ofrohet edhe atyre që nuk mund ta përballojnë atë.

100. Kjo pyetje trajton një sërë pengesash procedurale të cilat mund të rrezikojnë qasjen në drejtësi. Kërkesat e tepërta formale mund të çojnë në shpalljen e papranueshme të rasteve serioze dhe të bazuara mirë. Kompliksiteti i tyre mund të kërkojë më tej ndihmën e avokatit edhe në raste të drejtpërdrejta me pak ndikim financiar. Për t'i thjeshtuar procedurat gjyqësore, duhet të vihen në dispozicion formularë të thjeshtuar të standardizuar lehtë të qasshëm për publikun.

101. Afatet kohore shumë të shkurtra në praktikë mund të përbëjnë pengesë për individët për ushtrimin e të drejtave të tyre. Tarifat e larta mund të dekurajojnë shumë individë, veçanërisht ata me të ardhura të ulëta, që të paraqesin rastin e tyre në gjykatë.

102. Përgjigjet në pyetjet e mësipërme në lidhje me pengesat procedurale duhet të mundësojnë nxjerrjen e një përfundimi fillestar në lidhje me mënyrën e garantimit të qasjes në gjykatë. Megjithatë, përgjigja e plotë duhet të marrë parasysh perceptimin e publikut për këto çështje.

103. Gjyqësori nuk duhet të perceptohet si i distancuar nga publiku dhe i mbuluar me mister. Disponueshmëria, veçanërisht në internet, e informacionit të qartë në lidhje me mënyrën e paraqitjes së një rasti në gjykatë është një nga mënyrat e garantimit të angazhimit efektiv të publikut me sistemin gjyqësor. Informatat duhet të jetë lehtësisht të arritshme për tërë popullsinë, duke përfshirë grupet e cënueshme, si dhe të jenë të disponueshme në gjuhët e pakicave kombëtare dhe/ose imigrantëve. Gjykatat e instancave më të ulëta duhet të kenë shpërndarje të mirë territoriale dhe degët e tyre duhet të jenë lehtësisht të qasshme.

113. Për nevojën për një të drejtë efektive për qasje në gjykatë, shih p.sh. *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 4451/70, 21 janar 1975, § 26ff; *Yagtzilar dhe të tjerët kundër Greqisë*, 41727/98, 6 dhjetor 2001, § 20ff.

b. *Prezumimi i pafajësisë*¹¹⁴

A është i garantuar prezumimi i pafajësisë?

- i. A është i garantuar prezumimi i pafajësisë me ligj?
- ii. A ka rregulla të qarta dhe të drejta për barrën e provës?
- iii. A ka masa mbrojtëse ligjore që synojnë të pengojnë degët e tjera të pushtetit nga deklaratimet lidhur me fajësinë e të akuzuarve?¹¹⁵
- iv. A garantohet me ligj dhe në praktikë e drejta për të heshtur dhe për të mos e inkriminuar veten dhe anëtarët e familjes?¹¹⁶
- v. A ka garanci kundër zgjatjes së tepërt të paraburgimit?¹¹⁷

104. Presumimi i pafajësisë është thelbësor për të siguruar të drejtën për gjykim të drejtë. Që të garantohet prezumimi i pafajësisë, barra e provës duhet të jetë mbi prokurorinë.¹¹⁸ Rregullat dhe praktikat në lidhje me standardin e provës së kërkuar duhet të jenë të qarta dhe të drejta. Duhet të shmanget ushtrimi i paqëllimshëm ose i qëllimshëm i ndikimit nga degët e tjera të pushtetit shtetëror mbi autoritetin gjyqësor kompetent duke paragjykuar vlerësimin e fakteve. E njëjta gjë vlen edhe për disa burime private të opinionit si mediat. Zgjatja e tepërt e paraburgimit mund të konsiderohet si paragjykim i fajësisë së të akuzuarit.¹¹⁹

114. Neni 6.2 i KEDNJ, Neni 15 i PNDCP, Neni 8.2 i KEDNJ, Neni 7.1.b KEDNJ.

115. GJEDNJ *Allen de Ribemont kundër Francës*, 15175/89, 10 shkurt 1995, § 32 ff. Për përfshirjen e autoriteteve që nuk i përkasin gjyqësorit në çështjet që lidhen me një dosje penale, shih CDL-AD(2014)013, *Amicus Curiae* Brief në Çështjen Rywin kundër Polonisë (Kërkesa nr. 6091/06, 4047/07, 4070/07) pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (për Komisionet Hetimore Parlamentare). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi për çështjen *Rywin* më 18 shkurt 2016: shih në veçanti § 200 eff. Për çështjen e ndjekjes sistematike të kërkesave të prokurorëve (paragjykimi prokurorial), shih pikën II.E.1.a.xiii.

116. GJEDNJ *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 19187/91, 17 dhjetor 1996, § 68-69; *O'Halloran dhe Francis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 5809/02 dhe 25624/02, 29 qershor 2007, § 46ff, dhe jurisprudenca e cituar. Për inkriminimin e anëtarëve të familjes, shih p.sh. Gjykata Penale Ndërkombëtare, Rregullat e Procedurës dhe Provave, Rregulli 75.1.

117. Cf. Neni 5.3 i KEDNJ.

118. "Barra e provës i takon prokurorisë": GJEDNJ *Barberá, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, 10590/83, 6 dhjetor 1988, § 77; *Telfner kundër Austrisë*, 33501/96, 20 mars 2001, § 15; cf. *Grande Stevens dhe të tjerët kundër Italisë*, 18640/10, 18647/10, 18663/10, 18668/10 dhe 18698/10, 4 mars 2014, § 159.

119. Komiteti i të Drejtave të Njeriut, Komenti i Përgjithshëm Nr. 32, Neni 14: E drejta për barazi para gjykatave dhe tribunaleve dhe për një gjykim të drejtë, OKB Doc. CCPR/C/GC/32 (2007), IV

c. Aspekte të tjera të së drejtës për gjykim të drejtë

A janë standardet shitesë të gjykimit të drejtë të sanksionuara në ligj dhe a zbatohen në praktikë?

- i. A është garantuar barazia e palëve me ligj? A sigurohet ajo në praktikë?¹²⁰
- ii. A ka rregulla për përjashtimin e provave të siguruara në mënyrë të paligjshme?¹²¹
- iii. A nisen procedurat dhe a merren vendimet gjyqësore pa vonesa të panevojshme?¹²² A ka ndonjë mjet juridik kundër zgjatjes së panevojshme të procedurave?¹²³
- iv. A u sigurohet palëve ndërgjyqësore e drejta për qasje me kohë në dokumentet dhe dosjet gjyqësore?¹²⁴
- v. A është e garantuar e drejta për t'u dëgjuar?¹²⁵
- vi. A janë aktgjykimet të arsyetuara mirë?¹²⁶
- vii. A janë seancat dhe gjykimet të hapura për publikun, përveç në rastet e parapara me nenin 6.1 të KEDNJ-së apo për gjykimet në mungesë?
- viii. A janë të disponueshme procedurat e ankimimit, veçanërisht në rastet penale?¹²⁷
- ix. A dërgohen njoftimet e gjykatës siç duhet dhe pa vonesë?

105. E drejta e ankesës kundër një vendimi gjyqësor garantohet shprehimisht nga neni 2 i Protokollit 7 të KEDNJ-së dhe neni 14.5 i PNDKP për fushën

120. Shih p.sh., *Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28901/95, 16 shkurt 2000, § 60.

121. Shih p.sh., *Jalloh kundër Gjermanisë*, 54810/00, 17 korrik 2006, § 94ff, 104; *Göçmen kundër Turqisë*, 72000/01, 17 tetor 2006, § 75; *O'Halloran dhe Francis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 5809/02 dhe 25624/02, 29 qershor 2007, § 60.

122. Neni 6.1 i KEDNJ; Neni 8.1 i ACHR; Neni 7.1.d ACHPR («brenda një afati të arsyeshëm»).

123. CDL-AD(2010)039rev, § 94. Shih p.sh., *GJEDNJ Panju kundër Belgjikës*, 18393/09, 28 tetor 2014, § 53, 62 (mungesa e një mjeti efektiv juridik në rast të zgjatjes së tepërt të procedurave bie në kundërshtim me nenin 13 të kombinuar me nenin 6.1 të KEDNJ)

124. Kjo e drejtë nxirret në çështjet penale nga neni 6.3.b i KEDNJ (e drejta për të pasur kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes): shih p.sh. *Foucher kundër Francës*, 22209/93, 18 mars 1993, § 36.

125. . Cf. *GJEDNJ Micallef kundër Maltës*, 17056/06, 15 tetor 2009, § 78ff; *Neziraj kundër Gjermanisë*, 30804/07, 8 nëntor 2012, § 45ff.

126. "Neni 6 § 1 (neni 6-1) detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre": *GJEDNJ Hiro Balani kundër Spanjës*, 18064/91, 9 shtator 1994, § 27; *Jokela kundër Finlandës*, 28856/95, 21 maj 2002, § 72; shih gjithashtu *Taxquet kundër Belgjikës*, 926/05, 16 nëntor 2010, § 83ff. Nën titullin "E drejta për administrim të mirë", neni 41.2.c i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian parashikon "detyrimin e administratës për të dhënë arsye për vendimet e saj".

127. Për procedurat e apelimit, shih Përmbledhjen Ligjore të ODIHR për të Drejtat Ndërkombëtare për Gjykimin të Drejtë, f. 227

penale, dhe nga neni 8.2.h i KEDNJ-së në përgjithësi. Ky është një parim i përgjithshëm i sundimit të ligjit shpesh i garantuar në nivel kushtetues ose legjislativ nga legjislacioni vendor, veçanërisht në fushën penale. Çdo gjykatë, vendimet e së cilës nuk mund të ankimohen do të rrezikonte të vepronte në mënyrë arbitrarë.

106. Të gjitha aspektet e së drejtës për një gjykim të drejtë që janë shtjelluar më sipër, mund të nxirren nga e drejta për një gjykim të drejtë siç përcaktohet në nenin 6 të KEDNJ, siç shtjellohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ato sigurojnë që aktet juridikë të përfshihen siç duhet në të gjithë procesin gjyqësor.

d. Efektiviteti i vendimeve gjyqësore

A janë vendimet gjyqësore efektive?

- i. A ekzekutohen vendimet në mënyrë efektive dhe të menjëhershme?¹²⁸
- ii. A janë të shpeshta ankesat për mosekzekutim të vendimeve pranë gjykatave kombëtare dhe/ose Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut?
- iii. Cili është perceptimi i publikut lidhur me efektivitetin e vendimeve gjyqësore?

107. Vendimet gjyqësore janë thelbësore për zbatimin e Kushtetutës dhe legjislacionit. E drejta për gjykim të drejtë dhe sundimi i ligjit në përgjithësi do të ishin të pavlefshme nëse vendimet gjyqësore nuk do të ekzekutoheshin.

3. Drejtësia kushtetuese (nëse është e zbatueshme)

A sigurohet drejtësia kushtetuese në shtetet që parashohin shqyrtimin kushtetues (nga gjykata të specializuara kushtetuese apo nga gjykatat supreme)?

- i. A kanë individët qasje efektive në drejtësinë kushtetuese kundër akteve të përgjithshme, *p.sh.* a mund të kërkojnë individët vlerësim kushtetues të ligjit me veprim të drejtpërdrejtë ose me paraqitje të kërkesës kushtetuese në proceset e zakonshme gjyqësore?¹²⁹ Çfarë “interesi për të paditur” kërkohet nga ana e tyre?

128. Shih *p.sh.*, *Hirschhorn kundër Rumanisë*, 29294/02, 26 korrik 2007, § 49; *Hornsby kundër Greqisë*, 18357/91, 19 mars 1997, § 40; *Burdov kundër Rusisë*, 59498/00, 7 maj 2002, § 34ff; *Gerasimov dhe të tjerët kundër Rusisë*, 29920/05, 3553/06, 18876/10, 61186/10, 21176/11, 36112/11, 36426/11, 40841/11, 45381/11, 55929/11, 60822/11, 1 korrik 2014, § 167ff.

129. CDL-AD(2010)039rev, Studim qasjen individuale në drejtësinë kushtetuese, § 96.

- ii. A kanë individët qasje efektive në drejtësinë kushtetuese kundër akteve individuale që i prekin ata, *d.m.th.* a mund të kërkojnë individët vlerësimin kushtetues të akteve administrative apo vendimeve gjyqësore përmes veprimit të drejtpërdrejtë apo kërkesës kushtetuese?¹³⁰
- iii. A janë të detyruar Parlamenti dhe ekzekutivi që me rastin e miratimit të dispozitave të reja legislative ose rregullatore, t'i marrin parasysh argumentet e përdorura nga Gjykata Kushtetuese ose organi ekuivalent? A i marrin parasysh ato në praktikë?
- iv. A i plotësojnë parlamenti apo ekzekutivi boshllëqet legislative/rregullatore të identifikuara nga Gjykata Kushtetuese ose organi ekuivalent në afat të arsyeshëm?
- v. Kur vendimet e gjykatave të zakonshme shfuqizohen në procedurat e paraqitjes së ankesës kushtetues, a rihapen dhe zgjidhen rastet nga gjykatat e zakonshme duke marrë parasysh argumentet e përdorura nga Gjykata Kushtetuese ose organi ekuivalent?¹³¹
- vi. Nëse gjyqtarët kushtetues zgjidhen nga Parlamenti, a ka ndonjë kusht për shumicë të kualifikuar¹³² dhe garanci tjera për një përbërje të baraspeshuar?¹³³
- vii. A ka kontroll *ex ante* të kushtetutshmërisë nga ekzekutivi dhe/ose legjislativi?

108. Zakonisht, Komisioni i Venedikut rekomandon sigurimin e një gjykate kushtetuese ose organi të barasvlershëm. Ajo që është thelbësore është garantimi efektiv i përputhshmërisë së veprimeve të qeverisë, përfshirë legjislacionit, me Kushtetutën. Mund të ketë dhe mënyra të tjera për të siguruar përputhshmëri të tillë. Për shembull, legjislacioni finlandez parasheh një-

130. CDL-AD(2010)039rev, § 62, 93, 165.

131. CDL-AD(2010)039rev, § 202; CDL-AD(2002)005 Opinion për Projektligjin për Gjykata Kushtetuese e Republikës së Azerbajxhanit, § 9, 10.

132. CDL-AD(2004)043, Opinion për Propozimin për Ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Moldavisë (paraqitja e ankesës individuale në gjykatën kushtetuese), § 18, 19; CDL-AD(2008)030, Mendim për Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi, § 19; CDL-AD(2011)040, Opinion për ligjin për themelimin dhe rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, § 24.

133. CDL-AD(2011)010, Opinion për projekt-amendamentet e Kushtetutës së Malit të Zi, si dhe për projekt-amendamentet e ligjit për gjykatat, ligjit për prokurorinë e shtetit dhe ligjit për këshillin gjyqësor të Malit të Zi, § 27; CDL-AD(2012)024, Opinion për dy grupe projekt-amandamentesh në dispozitat kushtetuese që kanë të bëjnë me Gjyqësorin e Malit të Zi, § 33; CDL-AD(2009)014, Opinion për Ligjin për Gjykatën e Lartë Kushtetuese të Autoritetit Kombëtar Palestinez, § 13; Përbërja e Gjykatave Kushtetuese, Shkenca dhe Teknika e Demokracisë Nr. 20, CDL-STD(1997)020, f. 7, 21.

kohësisht rishikim *a priori* të kushtetutshmërisë nga Komiteti i së Drejtës Kushtetuese dhe kontroll gjyqësor *a posteriori* nëse zbatimi i një dispozite ligjore do të çonte në konflikt të dukshëm me Kushtetutën. Në kontekstin kombëtar në fjalë, kjo ka rezultuar të jetë e mjaftueshme.¹³⁴

109. Rishikimi i plotë gjyqësor i kushtetutshmërisë është vërtet mjeti më efektiv për të garantuar respektimin e Kushtetutës dhe përfshin një sërë aspekte të cilat janë paraqitur në hollësi si më sipër. Së pari, çështja e *locus standi* është shumë e rëndësishme: lënia e mundësisë për të kërkuar rishikim të kushtetutshmërisë vetëm degës legjislative ose ekzekutive të qeverisë mund të kufizojë së tepërmi numrin e rasteve dhe rrjedhimisht edhe shtrirjen e shqyrtimit. Prandaj, qasja individuale në juridiksionin kushtetues është zhvilluar në shumicën dërrmuese të vendeve, të paktën në Evropë.¹³⁵ Një qasje e tillë mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë (me anë të një kundërshtimi të ngritur pranë një gjykate të zakonshme, e cila ia referon çështjen gjykatës kushtetuese).¹³⁶ Së dyti, nuk duhet të ketë kufizime për sa i përket llojeve të akteve që mund t'i të jenë objekt i shqyrtimit kushtetues: kjo duhet të bëhet e mundshme për aktet normative (të përgjithshme) si dhe për aktet individuale (administrative ose gjyqësore). Megjithatë, mund të nevojitet ekzistimi i interesit individual nga ana e parashtruesit privat.

110. E drejta për gjykim të drejtë imponon zbatimin e të gjitha vendimeve të gjykatave, përfshirë ato në juridiksionin kushtetues. Vetëm shfuqizimi i legjislacionit që shkel Kushtetutën nuk është i mjaftueshëm për të eliminuar çdo efekt të një shkeljeje dhe, sido që të jetë, do të ishte i pamundur në rastet e mosveprimeve legjislative antikushtetuese.

111. Kjo është arsyeja pse ky dokument nënvizon rëndësinë e miratimit të legjislacionit nga Parlamenti në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese ose organit ekuivalent.¹³⁷ Ajo çka u tha për ligjvënësit dhe ekzekutivin vlen edhe për gjykatat: ato duhet të korrigjojnë rastet kur juridiksioni kushtetues ka konstatuar shkelje të kushtetutës, në bazë të argumenteve të kësaj të fundit.

112. "Legjitimiteti i një juridiksioni kushtetues dhe pranimi i vendimeve të tij nga shoqëria mund të varen shumë nga shkalla e shqyrtimit nga gjykata e vlerave të ndryshme shoqërore të rrezikuara, ndonëse vlerat e tilla përgjithësisht zëvendësohen në favor të vlerave të përbashkëta. Për këtë qëllim, në rregullat e përbërjes së këtyre juridiksioneve duhet të rrënjoset një ekuilibër që siguron respektimin e ndjeshmërive të ndryshme".¹³⁸ Shumica

134. CDL-AD(2008)010, Opinion për Kushtetutën e Finlandës, § 115ff.

135. Ekziston vetëm një përjashtim (i kufizuar) në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës me juridiksion kushtetues: CDL-AD(2010)039rev, § 1, 52-53.

136. CDL-AD(2010)039rev, § 1ff, 54-55, 56 ff.

137. Cf. CDL-AD(2008)030, Mendim për Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi, § 71.

138. CDL-STD(1997)020, f. 21.

e kualifikuar nënkupton kompromis politik dhe është një ndër mënyrat e sigurimit të përbërjes së baraspeshuar në rastet kur asnjë parti apo koalicion nuk ka shumicë të tillë.

113. Edhe në shtetet ku kontrolli *ex post* nga gjykata kushtetuese ose supreme është i mundur, kontrolli *ex ante* nga dega ekzekutive ose legjislativë e qeverisë ndihmon në parandalimin e shkeljes së kushtetutës.

F. Shembuj të sfidave të veçanta ndaj sundimit të ligjit

114. Ka shembuj të shumtë ku veprimet dhe vendimet të veçanta cenojnë sundimin e ligjit. Megjithatë, për shkak të aktualitetit dhe përhapjes së gjerë të tyre në kohën e hartimit të këtij dokumenti, në këtë pjesë janë paraqitur dy shembuj të tillë : korrupsioni dhe konflikti i interesit, si dhe mbledhja e të dhënave dhe mbikëqyrja.

1. Korrupsioni¹³⁹ dhe konflikti i interesit

a. Masat parandaluese

Cilat janë masat parandaluese që janë ndërmarrë kundër korrupsionit?

- i. Gjatë ushtrimit të detyrave publike, a zbatohen rregulla të posaçme të sjelljes për zyrtarët publikë? Këto rregulla a marrin parasysh:
 - (1) promovimin e integritetit në jetën publike nëpërmjet detyrave të përgjithshme (paanshmëria dhe neutraliteti etj.);
 - (2) kufizimet në dhurata dhe përfitime të tjera;
 - (3) garancitë në lidhje me përdorimin e burimeve publike dhe informatave që nuk janë destinuar të jenë publike;
 - (4) rregulloret për kontaktet me palët e treta dhe personat që kërkojnë të ndikojnë në vendim publik, përfshirë punët e qeverisë dhe parlamentit?
- ii. A ka rregulla që kanë si qëllim parandalimin e konfliktit të interesit në vendimmarrje nga zyrtarët publikë, *p.sh.*, duke kërkuar zbulimin paraprak të ndonjë konflikti të interesit?

139. Për çështjen e korrupsionit, shih Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO), *Imunitetet e zyrtarëve publikë si pengesa të mundshme në luftën kundër korrupsionit në Mësimet e nxjerra nga tre Raundet e Vlerësimit (2000-2010) - Artikuj tematikë*.

- iii. A zbatohen masat e mësipërme për të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë, *p.sh.*, nëpunësit civilë, zyrtarët e lartë të zgjedhur ose të emëruar në nivel shtetëror dhe lokal, gjyqtarët dhe bartës të tjerë të funksioneve gjyqësore, prokurorët etj.?
- iv. A i nënshtrohen disa kategori të zyrtarëve publikë një sistemi të deklarimit të të ardhurave, pasurive dhe interesave, apo kritereve të mëtejshme në fillim dhe në fund të një posti publik ose mandati, *p.sh.*, kritere të posaçme të integritetit për emërim, shkualifikime profesionale, kufizime pas përfundimit të marrëdhënies së punës (për të kufizuar mundësinë e ndërrimit të taborreve nga sektori publik në atë privat ose të ashtuquajturat “pantouflage”)?
- v. A janë marrë masa specifike parandaluese në sektorë të veçantë që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të madh për korrupsion, *p.sh.*, për të siguruar nivel adekuat të transparencës dhe mbikëqyrjes për tenderët publikë dhe financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore?

b. Masat në të drejtën penale

Cilat janë masat në të drejtën penale që janë ndërmarrë kundër korrupsionit?

- i. Deri në çfarë mase ryshfeti që përfshin një zyrtar publik përbën veprë penale?
- ii. A është i përkufizuar korrupsioni në dokumente politikash apo tekste të tjera, në përputhje me standardet ndërkombëtare? A ka dispozita të së drejtës penale që synojnë ruajtjen e integritetit publik, *p.sh.*, ushtrimin e ndikimit, shpërdorimin e detyrës, shkeljen e detyrave zyrtare?
- iii. Cilët zyrtarë publikë janë brenda fushëveprimit të masave të tilla, *p.sh.*, nëpunësit civilë, zyrtarët e lartë të zgjedhur ose të emëruar, përfshirë kreun e shtetit dhe anëtarët e qeverisë dhe asambleve publike, gjyqtarët dhe bartësit e tjerë të funksioneve gjyqësore, prokurorët etj.?
- iv. Çfarë pasojash kanë dënimet për veprat penale të lidhura me korrupsionin? A përfshijnë pasoja shtesë si përjashtimi nga marrja e funksionit publik ose konfiskimi i fitimeve?

c. Respektimi dhe zbatimi efektiv i masave parandaluese dhe represive

Si sigurohet respektimi efektiv i masave të mësipërme?

- i. Si perceptohet niveli i përgjithshëm i respektimit të masave dhe politikave kundër korrupsionit në nivel vendi?
- ii. A i respekton shteti rezultatet e monitorimit ndërkombëtar në këtë fushë?
- iii. A parashihen sanksione penale dhe administrative efektive, proporcionale dhe zbrapsëse për veprimet që lidhen me korrupsionin dhe mosrespektimin e mekanizmave parandalues?
- iv. A janë pajisur organet përgjegjëse për luftimin e korrupsionit dhe ruajtjen e integritetit të sektorit publik me burime adekuata, duke përfshirë kompetenca hetuese, personel dhe mbështetje financiare? A gëzojnë këto organe pavarësi të mjaftueshme funksionale nga ekzekutivi dhe legjislativi?¹⁴⁰
- v. A janë marrë masa për t'i bërë organet e mësipërme të qasshme për individët dhe për të inkurajuar zbulimin e akteve të mundshme korruptive, veçanërisht raportimin në linjat telefonike dhe a ka politika për mbrojtjen e sinjalizuesve¹⁴¹ nga hakmarrja në vendin e punës dhe pasoja të tjera negative?
- vi. A e vlerëson vetë shteti efektivitetin e politikave të tij kundër korrupsionit dhe a ndërmerren veprime adekuata korrigjuese kur është e nevojshme?
- vii. A është vërejtur në praktikë ndonjë dukuri që do të cenonte efektivitetin ose integritetin e përpjekjeve kundër korrupsionit, *p.sh.*, manipulimi i procesit legjislativ, mosrespektimi dhe moszbatimi i vendimeve dhe sanksioneve gjyqësore, imunitetet, ndërhyrja në përpjekjet e organeve kundër korrupsionit dhe organeve të tjera përgjegjëse për ekzekutim të masave, përfshirë frikësimin politik, instrumentalizimin e institucioneve të caktuara publike, frikësimin e gazetarëve dhe pjesëtarëve të shoqërisë civile që raportojnë për korrupsion?

115. Korrupsioni çon në arbitraritet dhe shpërdorim të pushtetit pasi vendimet nuk do të merren në përputhje me ligjin, gjë që do të sjellë vendime të natyrës arbitrare. Për më tepër, korrupsioni mund të pengojë zbatimin e barabartë të ligjit, prandaj i minon themelet e sundimit të ligjit. Megjithatë

140. Për çështjen e korrupsionit në gjyqësor, shih II.E.1.c.ii.

141. Shih Rekomandimin CM/Rec(2014)7 për mbrojtjen e sinjalizuesve të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

të tre degët e pushteteve preken nga korrupsioni, ai është shqetësim i veçantë për organet gjyqësore, prokuroriale dhe ligjzbatuese të cilat kanë rol instrumental në ruajtjen e efektivitetit të përpjekjeve kundër korrupsionit. Parandalimi dhe sanksionimi i veprimeve të lidhura me korrupsionin janë elementë të rëndësishëm të masave kundër korrupsionit, të cilat trajtohen në një sërë konventash ndërkombëtare dhe instrumente të tjera.¹⁴²

116. Parandalimi i konfliktit të interesit është element i rëndësishëm i luftës kundër korrupsionit. Konflikti i interesit mund të lindë në rrethana në të cilat një zyrtar publik ka interes privat (që mund të përfshijë një person të tretë, p.sh. të afërm ose bashkëshort) që mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrave të tij/saj zyrtare.¹⁴³ Çështja e konfliktit të interesit trajtohet në konventat ndërkombëtare dhe të drejtën e butë.¹⁴⁴ Legjislacioni për lobimin dhe kontrollin e financimit të fushatave mund të kontribuojë gjithashtu në parandalimin dhe sanksionimin e konfliktit të interesit.¹⁴⁵

2. Mbledhja e të dhënave dhe mbikëqyrja

a. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale

Si sigurohet mbrojtja e të dhënave personale?

- i. A janë të mbrojtura mjaftueshëm të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik në kuptim të mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit të tyre nga shteti, si dhe nga aktorët privatë? Cilat janë masat mbrojtëse për të siguruar që të dhënat personale të:

142. Shih për shembull Konventën e Kombeve të Bashkuar kundër Korrupsionit (CETS 173); Konventën e së Drejtës Civile mbi Korrupsionin (CETS 174); Protokollin Shtesë të Konventës të së Drejtës Penale (CETS 191); KM/ Rez(2000)10 për kodin e sjelljes për zyrtarët publikë; KM/Rez (97) 24 për njëzetë parimet udhëzuese për luftën ndaj korrupsionit.

143. CM/Rec(2000)10 mbi kodet e sjelljes për zyrtarët publikë, neni 13.

144. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, në veçanti neni 8.5; CM/Rec(2000)10, Shtojca - Modeli i kodit të sjelljes për zyrtarët publikë, nenet 13ff; kf. CM/Res (97) 24 për njëzet parimet udhëzuese për luftën kundër korrupsionit.

145. Komisioni i Venedikut miratoi në vitin 2013 një Raport mbi Rolin e Aktorëve Jashtë institucionalë në Sistemin Demokratik (Lobim) (CDL-AD(2013)011). Komiteti Evropian për Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ) kreu në vitin 2014 një studim fizibiliteti mbi instrumentin ligjor të Këshillit të Evropës në lidhje me rregullimin ligjor të aktiviteteve lobuese. Pritet që projekt-rekomandimi të dorëzohet për miratim në mbledhjen plenare të CDCJ-së në nëntor të vitit 2016.

- përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave ("ligjshmëria, drejtësia dhe transparenca");
- mbliidhen për qëllime të specifikuar, të qarta dhe legjitime dhe të mos përpunohen më tej në ndonjë mënyrë të papajtueshme me ato qëllime ("kufizim i qëllimit")?
- jenë adekuate, relevante dhe të kufizuara vetëm për atë që është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato përpunohen ("minimizim i të dhënave")?
- sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara ("saktësia")?
- të mbahen në formën që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale ("kufizimi i ruajtjes");
- përpunohen në atë mënyrë që të garantohet siguria e duhur e të dhënave personale, përfshirë mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm dhe nga humbja, shkatërrimi ose dëmtimi aksidental ("integriteti dhe konfidencialiteti")?¹⁴⁶

A i jepet subjektit të të dhënave informacion për të paktën mbi:

- ekzistimin e një skedari të automatizuar të të dhënave personale, qëllimet kryesore të tij;
- identitetin dhe detajet e kontaktit të kontrolluesit dhe të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave;
- qëllimet e përpunimit për të cilat destinohen të dhënat personale;
- periudhën për të cilën do të ruhen të dhënat personale;

